



Datë: 16.05.2025
Numër Protokolli: 3292/2025

A.nr.444/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.444/2025, të datës 11.03.2025, të parashtruar nga ankuesi L.S., kundër organit të punësimit: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve të punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.444/2025, të datës 11.03.2025, të parashtruar nga ankuesi L.S.

II. Anulohet Formuari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 28.02.2025, i bërë nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024.

III. Obligohet ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr. Ref.01/74 të datës 04.11.2024 të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën si në pikën II të dispozitivit.

IV. Detyrohet ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr. Ref.01/27 të datës 03.05.2024, që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën për periudhën 03.05.2024 deri më datë 04.11.2024, si dhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i caktuar sipas Vendimit me Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën 01.01.2024 deri më datë 03.05.2024, dhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

V. Obligohet ushtruesja aktuale e detyrës së Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si për pikën III dhe IV.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, L.S.(*në tekstin e mëtejme referuar* Ankuesi), më datë 11.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër kundër formulari të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për periudhën për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (*në tekstin e mëtejme referuar*: MINT), ndërsa kjo e fundit më datë 03.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2696/2025 të datës 23.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova (*në tekstin e mëtejme referuar* Kolegji i Këshillit) : Ankesën me numër protokoli 1506/2025, të datës 11.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuesit; Akt emërimit Ref.3/Nr.1 të datës 01.08.2022; Përshkrimin e detyrave të punës, të datës 03.10.2018; Plani vjetor i punës i vitit 2024-Departamenti i Turizmit; Raportin vjetor i Departamentit të Turizmit; Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës i datës 28.02.2025; Vendimin me numër protokoli 1355/02 të datës 29.12.2023; Vendimin A.nr.137/2024, të Këshillit; Vendimin A.nr.76/2025, të Këshillit; Vendimin me numër protokoli 924/03 të datës 10.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 03.04.2025; Vendimin Ref.Nr.01/74 të datës 04.11.2024; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 04.02.2015; Vendimin Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023; Akt emërimit me numër protokoli 1551 të datës 05.09.2019; Vendimin Nr.Ref.01/27 të datës 03.05.2025; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 08.06.2018; Plani vjetori i punës i vitit 2024, për Departamentin e Turizmit; Raportin javor i punës për periudhën 23.02-01.03.2024; Raportin javor i punës 23.10-01.11.2024; Raportin javor i punës për periudhën 29.01-02.02.2024; Raportin javor i punës për periudhën 26.07-02.08.2024; Raportin javor i punës për periudhën 26.04-03.05.2024; Raportin javor i punës për periudhën 29.07.2024-04.10.2024; Raportin javor i punës për periudhën 30.08-06.09.2024; Raportin javor i punës për periudhën 29.11.2024-06.12.2024; Raportin javor i punës për periudhën 31.05-07.06.2024; Raportin javor i punës nga i datës 01.11.2024; Raportin javor i punës për periudhën 02.08-09.08.2024; Raportin javor i punës për periudhën 29.01-09.02.2024; Raportin javor i punës për periudhën 03.05-10.05.2024; Raportin javor i punës për periudhën 04.10-11.10.2024; Raportin javor i punës për periudhën 09-13.09.2024; Raportin javor i punës për periudhën 13-19.09.2024; Raportin javor i punës për periudhën 08.11-15.11.2024; Raportin javor i punës për periudhën 09.02-16.02.2024; Raportin javor i punës nga data 11.10-18.10.2024; Raportin javor i punës për periudhën 12-19.01.2024; Raportin javor i punës për periudhën 12-19.04.2024; Raportin javor i punës për periudhën 13-19.09.2024; Raportin javor i punës për periudhën 12-20.12.2024; Raportin javor i punës për periudhën 14-21.06.2024; Raportin javor i punës për periudhën 18-22.11.2024; Raportin javor i punës për periudhën 16-23.08.2024; Raportin javor i punës për periudhën 17-24.05.2024; Raportin javor i punës për periudhën 21-25.10.2024; Raportin javor i punës për periudhën 19-29.01.2024; Raportin javor i punës për periudhën 19-26.04.2024;

Raportin javor i punës për periudhën 20-27.12.2024; Raportin javor i punës për periudhën 22-29.03.2024; Raportin javor i punës për periudhën 22-29.11.2024; Raportin javor i punës për periudhën 23-30.08.2024; Raportin javor i punës për periudhën 24-31.05.2024; Raportin javor i punës për periudhën 03-05.01.2024; Raportin javor i punës për periudhën 04-08.03.2024; Raportin javor i punës për periudhën 09-12.01.2024; Raportin javor i punës për periudhën 05-12.07.2024; Raportin javor i punës për periudhën 04-07.06.2024; Raportin javor i punës për periudhën 08-15.03.2024; Raportin javor i punës për periudhën 18-22.03.2024; Raportin javor i punës për periudhën 24-27.06.2024; E-mailin e datës 02.04.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit me Ref.3/Nr.1, të datës 01.08.2022, është i punësuar në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Turizmit* në kudër të MINT.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 28.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për periudhën për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024 dhe atë në nivelit e përgjithshëm të vlerësimit **E papranueshme**.

Ankuesi, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, pretendon se vlerësimi fillimisht nuk është nënshkruar nga asnjëra palë, duke theksuar po ashtu se nuk është bërë vlerësimi për tërë vitin 2024, duke vepruar në kundërshtim me nenin 10 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, si dhe se e njëjta në këtë formular ka potencuar vendim të Komisionit Disiplinor, mirëpo për të cilat i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshill.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht, Nenit 52, paragrafit 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, ku përcaktohet: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e*

vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrës/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrës/e vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ju referuar edhe Rregullores (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë (e cila ka qenë në fuqi deri më datë 04.10.2024) dhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë (e cila është e aplikueshme për periudhën 04.10.2024), të cilët përcaktojnë vlerësimin e rezultateve në punë, vlerësimin e realizimit të detyrave të punës, vlerësimin e aftësive profesionale, vlerësimin e aftësive metodologjike, personale dhe sociale, nivelet e vlerësimeve, periudhën e vlerësimit.

Në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit dhe bazuar në dispozitat e larte theksuara ligjore, Kolegji i Këshilli, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara ngase Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 28.02.2025, i realizuar nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, fillimisht nuk është i nënshkruar nga asnjëra palë, duke u vepruar në kundërshtim me paragrafin 12 të Nenit 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërsa po ashtu nga analizimi i të njëjtit formular, Kolegji, konstaton se në asnjë prej rubrikave të vlerësimit të aftësive profesionale, nuk rezulton të jenë dhënë komente nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo arsyetim se pse është vlerësuar me nivelet përkatëse ankuesi, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me aftësitë analitike, iniciativën dhe kreativitetin, komunikimin efektiv, bashkëpunimin në punë dhe ekip, adaptim dhe fleksibilitet si dhe tek respektimi i rregullave dhe procedurave, tek të cilat është vlerësuar me nivelin e papranueshme, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 11 të këtij neni, përveç se e njëjta në cilësinë e mbikëqyrës së drejtpërdrejtë të ankuesit, tek pjesa e IV. Vlerësimi i aftësive metodologjike, personale dhe sociale, ka lënë komentin, duke theksuar se, citoj: “Ka qenë në Komision Disiplinor dhe është dënuar me vendim nga Komisioni Disiplinor. Sjellje jo profesionale në punë dhe mos kontroll emocional.”, mirëpo nga shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi, mbi të cilën mund të vërtetohet se ankuesit për periudhën e vlerësuar, i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore nga Komisioni Disiplinor i organit përkatës të Punësimit, ndërlidhur me këtë koment, siç nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi se ankuesi ka mungesa të vazhdueshme në punë dhe mos iniciativë për punë ekipore, siç ka theksuar në e-mailin e datës 02.04.2025, dërguar Zyrtares së Lartë të Personelit znj. A.B, apo nëse e njëjta ka ndërmarrë ndonjë veprim kundrejt këtyre thënieve në këtë e-mail.

Ndërsa, tek katër (4) objektivat e përcaktuar në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë, ku për tri objektivet, ankuesi është vlerësuar me nivelin e papranueshme, ndërsa për objektivin e katërt është vlerësuar sipas nivelit ka nevojë për përmirësim, dhe se organi i punësimit me rastin e dërgimit të

përgjigjes në ankesë nuk ka argumentuar me asnjë provë të vetme lidhur me pretendimet e vlerësuesit se ankuesi nuk ka arritur objektivat apo se i njëjti nuk ka arritur përmbushjen e detyrave të punës, përkundrazi, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Raportit Vjetor të vitit 2024 të këtij departamenti dhe aktiviteteve të katër (4) prej objektivave të përcaktuara me këtë formular, rezulton se ky departament të cilën e udhëheq dhe menaxhon ankuesi, ka realizuar shumicën e objektivave të Planin Vjetor të Punës për vitin 2024.

Andaj si rezultat i kësaj, duke marr parasysh Raportin Vjetor të vitit 2024 për Departamentin e Turizmit si dhe raportet e ankuesit të bashkangjitura në përgjigjen në ankesë, nga organi i punësimit, apo thënë më konkretisht Raportin javor të punës për periudhën 23.02-01.03.2024; Raportin javor të punës për periudhën 23.10-01.11.2024; Raportin javor të punës për periudhën 29.01-02.02.2024; Raportin javor të punës për periudhën 26.07-02.08.2024; Raportin javor të punës për periudhën 26.04-03.05.2024; Raportin javor të punës për periudhën 29.07.2024-04.10.2024; Raportin javor të punës për periudhën 30.08-06.09.2024; Raportin javor të punës për periudhën 29.11.2024-06.12.2024; Raportin javor të punës për periudhën 31.05-07.06.2024; Raportin javor të punës të datës 01.11.2024; Raportin javor të punës për periudhën 02.08-09.08.2024; Raportin javor të punës për periudhën 29.01-09.02.2024; Raportin javor të punës për periudhën 03.05-10.05.2024; Raportin javor të punës për periudhën 04.10-11.10.2024; Raportin javor të punës për periudhën 09-13.09.2024; Raportin javor të punës për periudhën 13-19.09.2024; Raportin javor të punës për periudhën 08.11-15.11.2024; Raportin javor të punës për periudhën 09.02-16.02.2024; Raportin javor të punës nga data 11.10-18.10.2024; Raportin javor të punës për periudhën 12-19.01.2024; Raportin javor të punës për periudhën 12-19.04.2024; Raportin javor të punës për periudhën 13-19.09.2024; Raportin javor të punës për periudhën 12-20.12.2024; Raportin javor të punës për periudhën 14-21.06.2024; Raportin javor të punës për periudhën 18-22.11.2024; Raportin javor të punës për periudhën 16-23.08.2024; Raportin javor të punës për periudhën 17-24.05.2024; Raportin javor të punës për periudhën 21-25.10.2024; Raportin javor të punës për periudhën 19-29.01.2024; Raportin javor i punës për periudhën 19-26.04.2024; Raportin javor i punës për periudhën 20-27.12.2024; Raportin javor të punës për periudhën 22-29.03.2024; Raportin javor të punës për periudhën 22-29.11.2024; Raportin javor të punës për periudhën 23-30.08.2024; Raportin javor të punës për periudhën 24-31.05.2024; Raportin javor të punës për periudhën 03-05.01.2024; Raportin javor të punës për periudhën 04-08.03.2024; Raportin javor të punës për periudhën 09-12.01.2024; Raportin javor të punës për periudhën 05-12.07.2024; Raportin javor të punës për periudhën 04-07.06.2024; Raportin javor të punës për periudhën 08-15.03.2024; Raportin javor të punës për periudhën 18-22.03.2024; Raportin javor të punës për periudhën 24-27.06.2024; Kolegji i Këshillit, konstaton se ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr. Ref.01/74 të datës 04.11.2024 është e obliguar të ndërmarr veprimet me qëllim të rivlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën si në pikën II të dispozitivit dhe rivlerësimin duhet t'a bëjë mbi bazë të fakteve dhe provave konkrete duke respektuar në përpikëri dispozitat ligjore.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në parimin e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e ku nëpunësi civil duhet të vlerësohet për punën e tij për vitin kalendarik, në bazë të provave materiale të çështjes, konstaton se ankuesi nuk është vlerësuar për tërë vitin 2024, ngase i njëjti është vlerësuar vetëm për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, ndërsa për pjesën paraprake edhe pse ka pasur dy mbikëqyrës të drejtëpërdrejtë nuk është vlerësuar, ndaj në këtë kuptim të dispozitave të cekura më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se është obligim ligjor që mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për vartësit e tij, mirëpo mbi bazë të provave të lëndës rezulton se nuk është ndërmarr asnjë veprim me qëllim që ankuesi të vlerësohet edhe për pjesën tjetër të vitit sipas nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të

Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë dhe nenit 10 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Andaj Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi, ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e caktuar sipas Vendimit me Nr. Ref.01/27 të datës 03.05.2024, është e detyruar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën për periudhën 03.05.2024 deri më datë 04.11.2024, si dhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i caktuar sipas Vendimit me Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 është i detyruar të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën 01.01.2024 deri më datë 03.05.2024.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë—Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.444/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, L.S.;
- Organit të Punësimit: Sekretares së Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.